# DËSHMI ARKIVI

**A-423761**
VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Prindërit mund të shohin në kohë reale situatat me fëmijët e tyre”, Rama prezanton kamerat inteligjente në shkolla: Do doja të instaloheshin dhe në klasa – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/prinderit-mund-te-shohin-ne-kohe-reale-situatat-me-femijet-e-tyre-rama-prezanton-kamerat-inteligjente-ne-shkolla-do-doja-te-instaloheshin-dhe-ne-klasa/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 7 shtator 2026, 05:15:46 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 31 gusht 2026, 12:39:11 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `630e23c007d736863b7a99799cdbe7b8428602a6937ff4416785a7c8fcd4bb73` |
| TEKSTI | `6380d47f09647c2581cd95f33949136caf013f671ea50d25dc8f58ac06643899` |
| PAMJA | `70208b1b8e49fbabaf3cc1d8a96437751358088dce6045105e03dadbddc41dec` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `366f18dd7950104808219a805ba9757571b4ff8d92cf68be83636d36b93858f2` |
| E MËPARSHMJA | `c1665fd8697fdfdd0bf1d0c869cf373876d5cb20db9aee2058b5d7edc6a05cec` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/366f18dd7950104808219a805ba9757571b4ff8d92cf68be83636d36b93858f2`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Ilustrim · Vizion Plus

5 Elbasani nuk fal! Egnatia pëson humbjen e parë të sezonit

NEWSLETTER

**Përmbledhja e ditës në e-mail**

emaili juaj

Abonohu

Kryeministri Edi Rama ka folur për sistemin e ri të kamerave inteligjente të instaluara në 20 shkolla në Tiranë, duke theksuar se teknologjia e re synon të rrisë ndjeshëm sigurinë e nxënësve dhe stafit.

Gjatë prezantimit të sistemit në gjimnazin "Partizani", Rama tha se kamerat e vjetra ishin të pamjaftueshme për të monitoruar në kohë reale situatat dhe sjelljen në ambientet e përbashkëta të shkollave.

Sipas kryeministrit, sistemi i ri do t'u mundësojë edhe prindërve të kenë akses në kohë reale në pamjet e situatave ku përfshihen fëmijët e tyre.

***Rama:*** *Po kalojmë nga një gjeneratë kamerash të vjetra, të cilat ndihmonin deri në njëfarë mase por ishin të pamjaftueshme për të ndjekur situata në kohë reale dhe për të pasur një pamje të qartë të vijës së sjelljes në tërësi në mjedisin e përbashkët, te një gjeneratë e re kamerash që i krijon siguri shumë më të madhe shkollës dhe i jep prindërve mundësinë që të kenë në kohë reale sa herë që ata duan nëj pamje të çdo situate  ku është i përfshirë fëmija i tyre. Unë do doja që të kishte kamera dhe në klasa, pasi e kemi parë shembullin se sa shumë ndihmon për rregullin, kundër kopjes, por duke qenë se këtu ka një kufizim të qartë të bërë për sa i përket vendeve të BE-së, ne nuk do luftojmë me këtë kufizim. Këtu jemi në kushtet kur garantojmë një pamje në kohë reale, garantojmë një aleat shumë të fortë të punonjëvse të sigurisë dhe punonjësve të shkollave. Me*

*këto kamera mund të shikohet çdo person që mund të vijë nga jashtë, çdo veprim i dyshimtë. Është e pamundur të pish duhan pa u detektuar. Është një sistem për të cilin kemi punar shumë.*

Sistemi aktual është instaluar në 20 shkolla, kryesisht në institucionet me numër të lartë nxënësish. Rama bëri me dije se projekti do të zgjerohet edhe në shkolla të tjera në vend.

Ai tha gjithashtu se pas disa muajsh do të bëhet një vlerësim i projektit, përmes marrjes së mendimeve nga prindërit dhe mësuesit, duke shprehur bindjen se sistemi i ri do të rrisë ndjeshëm ndjenjën e sigurisë në shkolla.

***Rama:*** *Janë 20 shkolla, do vazhdojmë t'i shtojmë. Kemi zgjedhur shkollat më të populluara dhe ku ka nevojë edhe për të bërë një lloj raporti mbi këtë projekt që mbas X muajsh të marrim përshtypjet e pirndërve, mësuesve. Jemi të bindur që të gjithë do ndihen shumë më të qetë.*

#EdiRama

**Xhuljana Zhuleku**
Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.
Të gjithë artikujt

## Vazhdo të lexosh



VENDI

**Nis viti i ri shkollor, Skënder Hita mesaz...**

Xhuljana Zhuleku · 16 minuta më parë



VENDI

**Alarmi i rremë për bombë në shkollën...**

Xhuljana Zhuleku · 22 minuta më parë



EKONOMI

**Nafta "kapërcen" 230 lekë për litër,...**

Xhuljana Zhuleku · 50 minuta më parë

Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

• LIVE

**Lajme**
Politikë
Bota
Vendi
Kronikë
Lifestyle

**Programe**
Programe
Seriale
Guida TV
Video
Ekipi i Vizion Plus

**Rrjeti**
Rreth nesh
Karriera
Kontakt
Reklamo me ne
Dërgo lajmin tënd

**Ligjore**
Kushtet e përdorimit
Privatësia
Cookies
Politika editoriale

© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara

vizionplus.tv Kthehu lart ↑

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.